REPUBLIKA E SHQIPERISË
GJYKATA E LARTË
KOLEGJI CIVIL

Nr.11243-01448-00-2016 i Regj. Themeltar
Nr. 00-2016-1896 i Vendimit (189)

V E N D I M

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë i përberë nga:

Artan BROCI	**Kryesues**
Majlinda ANDREA	**Anëtar**
Admir THANZA	**Anëtar**

Në seancën gjyqësore të datës 01.06.2016, mori në shqyrtim çështjen civile me nr.11243-01448-00-2016, që u përket palëve:

PADITËS: **Shoqëria "Akt. I. Post Engineering".**

E PADITUR: **Shoqëria "Sphinx" Shpk,**

OBJEKTI: *Pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv për një detyrim mbi shumën 6,846,01 Euro.*
Pezullimin e ekzekutimit të veprimeve të Përmbaruesit Gjyqësor.

BAZA LIGJORE: *Neni 609, 60, 615 të K.Pr.Civile.*

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr.1214, datë 18.02.2016, ka vendosur: *"Nxjerrjen jashtë juridiksionin gjyqësor të çështjes civile me Nr.13195/2982, datë Regjistrimi 23.10.2015, me palë paditëse Shoqëria "Ark 1 Post Engineering" në degën e shoqërisë së huaj, me palë të paditura Shoqëria "Sphinx" Shpk dhe Përmbaruesi Gjyqësor Gentian Franku, me objekt: "Pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv për një detyrim mbi shumën 6,846,01 Euro. Pezullimin e ekzekutimit të veprimeve të Përmbaruesit Gjyqësor".*

Kundër vendimit nr.1214, datë 18.02.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ka paraqitur **ankim të veçantë, pala paditëse Shoqëria "Ark I Post Enginieering".**

- *Vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë është marrë në kundërshtim me ligjin, pasojë e moskuptimit të natyrës se mosmarrëveshjes dhe në vështrim të shkakut ligjor dhe mjetit juridik të zgjedhur nga paditësi.*
- *Pavlefshmëria e Titullit Ekzekutiv, parashikuar nga neni 609 i K.Pr.Civile, është një gjykim që përqëndrohet mbi shqyrtimin e masës e sasisë së të drejtës materiale që gjendet në titullin ekzekutiv. Debitori mund kërkojë pavlefshmërinë e titullit duke*

parashtruar vetëm fakte dhe ngjarje me anën e së cilave kundërshtohet urdhërueshmëria e asaj që është shprehur më përpara në titullin ekzekutiv, pasi kjo ndikon mbi të drejtën proçeduriale të ekzekutimit të detyrueshëm, pra mbi vetë titullin ekzekutiv. Ky mjet ngrihet gjatë fazës së ekzekutimit të detyrueshëm.

- *Parashikimet e bëra në këtë marrëveshje nuk janë të zbatueshme në shitjen objekt gjykimi pasi:*
- *-Nga një lexim literal i këtij paragrafi lehtësisht arrihet në përfundimin se kjo klauzole është e parashikuar në lidhje me mosmarrëveshjet që do të lindin mbi zbatimin apo kushtet e zbatimit të detyrimeve që kishin palët ndërmjet tyre, që buronin nga kjo marrëveshje.*
- *-Në çështjen objekt gjykimi nuk diskutohet as përmbushje e detyrimit dhe aq shumë mënyra e përmbushjes së detyrimit. Objekt i gjykimi është vlefshmëria e titullit ekzekutiv për sa i përket faturës tatimore përkatëse, me vlerën që ajo përfaqëson. Ky mjet ligjor nuk përfaqëson një vlerësim të marrëveshjes së lidhur ndërmjet padive por është një mjet i posaçëm që përdoret në fazën e ekzekutimit të detyrueshëm,që kundërshton në mënyrë të posaçme vetëm përmbajtjen e faturës (titullit ekzekutiv).*
- *-Nga ana tjetër ka qënë pikërisht pala e paditur që i është drejtuar juridiksionit gjyqësor për të bërë të mundur përmbushjen e pretendimeve të tyre,duke investuar gjykatën për lëshimin e urdhërit të ekzekutimit, ndërkohë kundërshtimet që kemi ne për këtë faturë kërkon ti nxjerri jashtë juridiksionit gjyqësor.*
- *Në zbatim të nenit 400,404 të K.Pr.Civile, parashikimet e bëra në këtë marrëveshje për gjykimin e çështjes në Arbitrazh në Tiranë, janë të pazbatueshme se ne të nuk përcaktohet as mënyra e caktimit të arbitrit apo Qëndra në Shqipëri për gjykimin e mosmarrëveshjeve.*
- *-Parashikimi i bërë se në rast pamundësie të zhvillimit të arbitrazhit në Shqipëri ai do të zhvillohet në Paris Francë është i pavlefshëm dhe për pasojë i pazbatueshëm në rastin konkret pasi do të ndodheshim para një arbitrazhi ndërkombëtar në zbatim të nenit 400 dhe 472 të K.Pr.Civile të cilat përcaktojnë se qëllimi ndërmjet arbitrazhit të brendshëm dhe atij të huaj qëndron në faktin se ku ndodhet vendi i procedurës, nëse ajo ndodhet në shtetin shqiptar apo jashtë. Palët në gjykim, paditësi dhe pala e paditur janë persona juridikë të regjistruar sipas ligjeve në fuqi në territorin e Republikës së Shqipërisë, në këto kushte parashikimet e Nenit 400 e vijues të K.Pr.Civile për gjykimin në arbitrazh janë të vlefshme dhe aplikohen vetëm në ato raste kur palët kanë zgjedhur me marrëveshje gjykimin e mosmarrëveshjeve të tyre në arbitrazh dhe në ato raste kur arbitrazhi zbatohet sipas parimit të K.Pr.Civile.*
- *-Kushti i parë për të pasur gjykim arbitrazhi ndërkombëtar sipas marrëveshjeve të palëve kërkon si kusht të parë atë të qenies së një personi në marrëveshje subjekt i një shteti tjetër. Kjo në zbatim të Nenit 2 të Konventës "Për Njohjen dhe Ekzekutimin e Vendimeve të Huaja të Arbitrazhit", New York me datë 10.06.1958, ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me ligjin nr.8688, datë 09.11.2000, "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën "Për Njohjen dhe Ekzekutimin e Vendimeve të Huaja të Arbitrazhit". Në rastin konkret ndodhemi përpara dy personave juridikë shqiptarë, te regjistruar sipas ligjit Shqiptar dhe kanë selinë e tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë.*
- *-Gjithashtu neni 1 i Konventës Europiane mbi Arbitrazhin Tregtar Ndërkombëtar të Gjenevës datë 21.04.1961, në të cilën Republika e Shqipërisë ka aderuar me ligjin 8687, datë 09.11.2000 "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Europiane të Arbitrazhit", parashikon se për të pasur arbitrazh ndërkombëtar kushti i parë ka të bëjë më natyrën e subjekteve dhe konsiston në faktin se ato duhet ti kenë selitë e tyre në dy vende të ndryshme dhe kushti i dytë ka të bëjë me atë që*

mosmarrëveshjet që duhet të zgjidhen një arbitrazh ndërkombëtar kanë të bëjnë me marrëdhënie ndërkombëtare. Parimi i përcaktuar në dy konventat e sipërcituara është se palët mund t'i drejtohen një arbitrazhi ndërkombëtar në rastin kur ato janë persona Juridikë të dy vendeve të ndryshëm.

- *Sa më sipër, vendimi i gjykatës është marrë në kundërshtim me ligjin dhe cënon të drejtën e aksesit të palës ankuese për të marrë një zgjidhje gjyqësore të pretendimeve të tij.*
- *Në këto kushte përfundimisht kërkojmë prishjen e vendimit dhe kthimin e çështjes për rigjykim pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.*

KOLEGJI CIVIL I GJYKATËS SË LARTË

pasi dëgjoi relatimin e gjyqtarit Artan Broci, dhe pasi e bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N

I. Rrethanat e faktit

Shoqëria "Ark I Post Enginieering" degë e shoqërisë së huaj, është shoqëri e së drejtës shqiptare e rregjistruar në datë 05.09.2013 pranë QKR-së dhe ka si objekt të veprimtarisë së ndër të tjera "Krijimi dhe drejtimi në infrastrukturë në sektorët e transporteve dhe të ndërtimeve, teknikave të projektimit, kryerjes së shërbimeve teknike të përgjithshme, kryerjes së shërbimeve të inxhinerisë civile dhe inxhinerisë së intergruar".

Në realizim të objektit të veprimtarisë së saj dhe në përputhje me të, kjo shoqëri në datë 24.03.2014 ka hyrë në marrëdhënie kontraktore me shoqërinë "Sphinx" shpk, e cila është një shoqëri edhe kjo gjithashtu e së drejtës shqiptare e cila ka për objekt të veprimtarisë së saj ndër të tjera dhe "Projektim, furnizim dhe instalim i sistemeve të sigurisë, telekomunikacion dhe sistemet e IT".

Marrëdhënia kontraktuale dhe veprimtaria mes palëve ndërgjyqëse kanë për objekt "Blerjen dhe instalimin e sistemit të sigurisë për Muzeun e Bankës së Shqipërisë".

Rezulton nga dokumentacioni shkresor i depozituar në gjykim se marrëdhëniet mes palëve ndërgjyqëse janë rregulluar me akt juridiko- formal, përkatësisht me Marrëveshje për Blerjen dhe Instalimin e Sistemit të Sigurisë, e datës 24.03.2014.

Mosmarrëveshjet midis palëve kanë filluar kur sipas pretendimit të palës së paditur, pala paditëse nuk ka likujduar një faturë tatimore nr.58, datë 26.12.2014, për të cilën është lëshuar urdhëri i ekzekutimit dhe më pas ka kaluar për ekzekutim pranë përmbaruesit gjyqësor Gentian Franku.

Me padinë e ngritur pala paditëse ka kërkuar pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv për një detyrim mbi shumën 6,846,01 Euro dhe pezullimin e veprimeve përmbarimore.

Në seancë gjyqësore pala e paditur Shoqëria "Sphinx" Shpk kërkoi nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor duke iu referuar për këtë nenit 17 të marrëveshjes së lidhur ndërmjet palëve ndërgjyqëse datë 24.03.2014 me këtë përmbajtje: Ligji dhe Arbitrazhi: "*Kjo marrëveshje do të qeveriset sipas ligjeve shqiptare. Çdo palë do të jetë në përputhje me ligjin shqiptar për fushën ku operojnë. Palët do të bëjnë më të mirën të zgjidhin mosmarrëveshjet*

që mund të lindin midis tyre miqësisht. Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin midis tyre në lidhje me marrëveshjen, do të zgjidhen në përputhje me Rregullat e Arbitrazhit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë me një arbitër të caktuar në përputhje me rregullat. Arbitrazhi bëhet në Tiranë, Shqipëri, në gjuhën shqiptare, nëse nuk është e mundur, arbitrazhi do të bëhet në Paris, Francë në gjuhën Angleze"

Bazuar në parashikimin e mësipërm kontraktor pala e paditur shoqëria "Sphinx" Shpk në referencë të nenit 36, 37 e 59 të K.Pr.Civile dhe Ligjit nr.8688, datë 09.11.2000, "Për aderimin e R.SH në Konventën për Njohjen dhe Ekzekutimin e Vendimeve të Huaja të Arbitrazhit", ka kërkuar nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor.

Përfaqësuesit e palës paditëse prapësoi pretendimet e palës së paditur, duke argumentuar se: "…Padia e ngritur ka të bëjë me pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv lidhur me faturën tatimore të lëshuar nga pala e paditur, pra është një padi që është ngritur në fazën e ekzekutimit të vendimit dhe nuk ka të bëjë me parashikimet e nenit 17 të Marrëveshjes së datës 24.03.2014, aq më tepër që vetë pala e paditur ka zgjedhur juridiksionin gjyqësor duke kërkuar lëshimin e urdhërit të ekzekutimit për atë faturë tatimore.

Parashikimi për pamundësi të zhvillimit të arbitrazhit në Shqipëri ai do të zhvillohet në Paris, Francë, është i pavlefshëm dhe i pazbatueshëm pasi do të ndodheshim para një arbitrazhi ndërkombëtar dhe në zbatim të nenit 400 e 472 të K.Pr.Civile të cilët përcaktojnë se dallimi midis arbitrazhit të brendshëm dhe atij të huaj qëndron në faktin se ku ndodhet vendi i proçedurës. Të dyja palët janë persona juridikë të rregjistruar sipas legjislacionit shqiptar dhe kanë selinë në territorin e Republikës së Shqipërisë. Kushtet për të pasur një gjykim arbitrazhi ndërkombëtar është qënia e subjekteve në shtete të ndryshme dhe me seli në shtetet e tyre dhe mosmarrëveshjet që duhet të zgjidhen duhet të kenë të bëjnë me marrëdhënie ndërkombëtare.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr.1214, datë 18.02.2016, ka vendosur: *"Nxjerrjen jashtë juridiksionin gjyqësor të çështjes civile me Nr. 13195 / 2982, datë Regjistrimi 23.10.2015, me palë paditëse Shoqëria "Ark 1 Post Engineering" në degën e shoqërisë së huaj, me palë të paditura Shoqëria "Sphinx" Shpk dhe Përmbaruesi Gjyqësor Gentian Franku, me objekt: "Pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv për një detyrim mbi shumën 6,846,01 Euro. Pezullimin e ekzekutimit të veprimeve të Përmbaruesit Gjyqësor"*.

Gjykata ndër të tjera ka arsyetuar se: *"...në analizë të pretendimeve të palëve dhe provave të paraqitura të administruara nga kjo gjykatë, çmon se çështja nuk është në juridiksionin gjyqësor dhe për pasojë duhet të deklarohet mungesa e këtij juridiksioni duke arsyetuar se:*

Juridiksioni gjyqësor përfaqëson atributet e gjykatës së zakonshme të përcaktuara me ligj për të shqyrtuar një çështje gjyqësore konkrete. Një aftësi e tillë parimisht i është dhënë gjykatës nga ligji si një tagër i përgjithshëm përjashtimet nga i cili si rregull ekzistojnë për dy shkaqe: ***1)****Për shkak të një kufizimi ligjor;* ***2)****për shkak të një marrëveshjeje* ***të vullnetshme*** *dhe* ***të vlefshme*** *mes palëve për shmangien nga parimi i përgjithshëm i juridiksionit dhe adresimin e mosmarrëveshjes për zgjidhje në një juridiksion tjetër.*

Konstatohet se palët ndërgjyqëse, përkatësisht Shoqëria "Ark I Post Enginieering" degë e shoqërisë së huaj dhe Shoqëria "Sphinx" Shpk, me marrëveshje të plotë dhe në përputhje me parimin universal të lirisë kontraktuale kanë nënshkruar kontratën e datës 24.03.2014 duke përcaktuar në nenin 17 të saj autoritetin që do të zgjidhë mosmarrëveshjet lidhur me

marrëveshjen e datës 24.03.2014. Në këtë marrëveshje palët kanë përcaktuar në mënyrë të detajuar se mosmarrëveshja do të zgjidhen në përputhje me Rregullat e Arbitrazhit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë me një arbitër të caktuar në përputhje me rregullat. Arbitrazhi bëhet në Tiranë, Shqipëri, në gjuhën shqiptare, nëse nuk është e mundur, arbitrazhi do të bëhet në Paris, Francë në gjuhën Angleze"

Pretendimi i palës paditëse se marrëveshja e datës 24.03.2014, është e pavlefshme dhe e pazbatueshme, është i pabazuar në ligj.

Në ligjin nr.8687, datë 09.11.2000, "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në konventën Evropiane të Arbitrazhit , neni 6 pika 2 parashikohet shprehimisht:

> ***"Gjykata e shteteve kontraktuese, në marrjen e vendimit lidhur me ekzistencën ose vlefshmërinë e një marrëveshjeje arbitrazhi, do të shqyrtojë vlefshmërinë e një marrëveshjeje të tillë duke iu referuar zotësisë juridike të palëve, sipas ligjit të tyre të zbatueshëm,si dhe lidhur me çështje të tjera si vijon: -<u>Sipas ligjit, të cilit palët kanë nënshkruar marrëveshjen e tyre të arbitrazhit</u>".***
>
> *Në referim të kësaj dispozite të detyrueshme për zbatim nga gjykata dhe me përparësi me ligjin e zakonshëm procedurial civil gjykata konstaton se në nenin 17 të Marrëveshjes së datës 24.03.2014 palët kanë përcaktuar shprehimisht se: "Kjo marrëveshje do të qeveriset sipas ligjeve shqiptare. Çdo palë do të jetë në përputhje me ligjin shqiptar për fushën ku operojnë.*
>
> *Siç edhe u theksua më lart, të dy shoqëritë palë në këtë marrëveshje janë regjistruar dhe themeluar në përputhje me legjislacionin Shqiptar të Shoqërive Tregtare, dhe janë Regjistruar në Regjistrin Shqiptar të Shoqërive Tregtare; për rrjedhojë në përcaktimin e vlefshmërisë së marrëveshjes së arbitrazhit, gjykata vlerëson se palët në këtë çështje kanë të njëjtën zotësi juridike e cila rregullohet në bazë të legjislacionit shqiptar.*
>
> *Në legjislacionin shqiptar dhe në jurisprudencë kontrata përkufizohet si "veprimi juridik me anë të së cilës një ose disa palë krijojnë, ndryshojnë ose shuajnë një marrëdhënie juridiko-civile" (neni 659 i K.Civil Shqiptar).*
>
> *Në nenin 663 të K.Civil janë renditur kushtet e nevojshme për ekzistencën e kontratës duke parashikuar se: "Konditat e nevojshme për qënien e kontratës janë: pëlqimi i palës që merr përsipër detyrimin, shkaku i ligjshëm në të cilin mbështetet detyrimi, objekti që formon lëndën e kontratës dhe forma e saj e kërkuar nga ligji".*
>
> *Kontrata e datës 24.03.2014 përfaqëson një kontratë të shkruar me të drejta dhe detyrime të dyanshme, lidhur dhe nënshkruar me vullnet të plotë e të lirë prej palëve të saj dhe në një gjuhë të pranuar nga palët. Vetë akti i nënshkrimit të kontratës dhe ekzekutimi i mëvonshëm i saj nga të dy palët reflekton pranimin e kësaj forme të kontratës. Kjo kontratë ka të përcaktuar qartë palët, përmban të drejta dhe detyrime të dyanshme, objekti i saj është i përcaktuar dhe i ligjshëm. Për shkak të llojit dhe sferës së veprimtarisë që ajo trajton kemi të bëjmë me një kontratë objekti i të cilës kërkon ekzekutimin e saj me veprime të shprehura, kryerjen e punimeve nga njëra palë kundrejt detyrimit për pagimin e vlerës së tyre nga pala tjetër. Ekzistenca e njëkohëshme e këtyre elementëve përbëjnë kushtet ligjore për qenien e një kontrate të vlefshme juridikisht në kuptim të nenit 663 të K.Civil .*
>
> *Në këto kushte, pretendimi i palës paditëse se parashikimi për pamundësi të zhvillimit të arbitrazhit në Shqipëri ai do të zhvillohet në Paris, Francë, është i pavlefshëm dhe i pazbatueshëm, nuk gjen asnjë mbështetje ligjore.*
>
> *Nga ana tjetër gjykata konstaton se klauzola e arbitrazhit e përcaktuar në nenin 17 te marrëveshjes referon në një institucion Arbitrazhi Ndërkombëtar në Tiranë Shqipëri*

dhe në pamundësi në Paris, Francë, përkatësisht dhe në përputhje me Konventën ka përcaktuar se arbitrat zgjidhen sipas Rregullave të Arbitrazhit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë.
Në këto kushte, në referencë të nenit 17 të kontratës së datës 24.03.2014 si dhe referuar në nenet 403 dhe 404 të K.Pr.Civile, klauzola e arbitrazhit për gjykimin e mosmarrëveshjes mes palëve ndërgjyqëse është e vlefshme dhe për rrjedhojë, mosmarrëveshja e paraqitur për shqyrtim nuk është në juridiksionin gjyqësor , dhe në referencë të nenit 59 të K.Pr.Civile, Gjykata konkludon në nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit...".

Kundër vendimit nr.1214, datë 18.02.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ka paraqitur **ankim të veçantë,** pala paditëse Shoqëria "Ark I Post Enginieering",
Duke pretenduar se vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë është marrë në kundërshtim me ligjin, pasojë e moskuptimit të natyrës se mosmarrëveshjes dhe në vështrim të shkakut ligjor dhe mjetit juridik të zgjedhur nga paditësi.

II. Ligji i zbatueshëm:

Kodi i Procedurës Civile i cili parashikon që:

Neni 14 i K.Pr.Civile: *"Gjykata ka për detyrë që të zhvillojë një proces të rregullt ligjor, nëpërmjet garantimit të zhvillimit të një hetimi të plotë dhe të gjithanshëm, në përputhje me ligjin".*
Neni 16§1 i K.Pr.Civile:*"Gjykata zgjidh mosmarrëveshjen në përputhje me dispozitat ligjore dhe normat e tjera në fuqi, që janë të detyrueshme të zbatohen prej saj. Ajo bën një cilësim të saktë të fakteve dhe veprimeve që lidhen me mosmarrëveshjen, pa u lidhur me përcaktimin që mund të propozojnë palët".*
Neni 59 i K.Pr.Civile: *" Gjykata në çdo fazë dhe shkallë të gjykimit, qoftë edhe kryesisht , merr në shqyrtim nëse çështja që shqyrton, bën pjesë në juridiksionin gjyqësor apo atë administrativ. Kundër vendimit të dhënë për një rast të tillë, mund të bëhet ankim i veçantë në Gjykatën e Lartë".*
Neni 404 i K.Pr.Civile: Pavlefshmëria e marrëveshjes për arbitrazh.*" Është i pavlefshëm kushti për gjykimin e mosmarrëveshjes me arbitrazh, kur nuk pasqyrohet me shkrim në vet marrëveshjen kryesore të palëve ose me një dokument tjetër të shkruar që i referohet asaj, siç mund të jetë telegrami, teleksi e çdo mjet tjetër i saktë që përbën provë shkresore. Marrëveshja e palëve, sipas paragrafit të parë, është e pavlefshme, në rast se në atë nuk parashikohet mënyra e caktimit të arbitrit ose arbitrave, si dhe objekti i mosmarrëveshjes, kur ajo efektivisht ka lindur. Marrëveshja për gjykimin me procedurë arbitrazhi shfuqizohet, kur një arbitër i caktuar sipas kësaj procedure nuk pranon misionin e besuar.*

Ligji nr.10428, datë 2.06.2011, "Për të drejtën ndërkombëtare private" i cili parashikon që:

Neni 71: *"Gjykatat shqiptare kanë juridiksion në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve juridiko-civile me elemente të huaja, nëse pala e paditur ka vendqëndrimin e zakonshëm në Republikën e Shqipërisë, përveçse kur rregullat e këtij kreu parashikojnë ndryshe.."*
Neni 72: *Pavarësisht nga rregullat e këtij ligji, gjykatat shqiptare kanë juridiksion ekskluziv në çdo rast për gjykimin e:*
a) çështjeve me objekt të drejtën e pronësisë dhe të drejta të tjera reale mbi sende të paluajtshme, si dhe qiranë dhe të drejtat që rrjedhin nga përdorimi i pasurive të paluajtshme kundrejt shpërblimit, kur këto ndodhen në Republikën e Shqipërisë;

b) çështjeve me objekt vendimet e organeve të shoqërive tregtare, kur shoqëria ka vendqëndrimin e zakonshëm në Republikën e Shqipërisë;
c) çështjeve me objekt themelimin, mbarimin e personave juridikë, si dhe paditë me objekt vendimet e organeve të tyre, kur personi juridik ka selinë në Republikën e Shqipërisë;
ç) çështjeve me objekt vlefshmërinë e regjistrimit në regjistrat e gjykatave ose organeve shtetërore shqiptare;
d) çështjeve me objekt vlefshmërinë e regjistrimit të të drejtave intelektuale, për sa kohë që këto regjistrime ose kërkesa për këto regjistrime është bërë në Republikën e Shqipërisë;
dh) çështjeve, të cilat lidhen me ekzekutimin në Republikën e Shqipërisë të titujve ekzekutivë.

Neni 80: *"Gjykatat shqiptare kanë juridiksion ndërkombëtar edhe në rastet e mëposhtme:**...***
b) kur padia ka për objekt një kontratë ose pretendime që rrjedhin nga një kontratë dhe vendi, në të cilin është përmbushur ose duhej përmbushur detyrimi, ndodhet në Republikën e Shqipërisë;(...).

III. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë vlerëson se:

Vendimi nr.1214, datë 18.02.2016, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është marrë në zbatim të gabuar të ligjit procedural dhe material dhe si i tillë ai duhet të prishet e çështja te kthehet për vazhdimin e gjykimit në po atë gjykatë.

Ky Kolegj vlerëson se *ankimi i veçantë* i paraqitur nga **paditësi** Shoqëria "Ark I Post Enginieering" përmban shkaqe ligjore nga ato të parashikuara në nenin 472 të K.Pr.Civile, të cilat e bëjnë të cenueshëm vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Ky Kolegj çmon se çështja e juridiksionit është një nga çështjet më të rëndësishme procedurale, mosrespektimi dhe moszgjidhja drejt e së cilës sjell automatikisht prishjen e vendimit. Përcaktimi i saktë i juridiksionit, pra nëse çështja hyn në juridiksionin gjyqësor apo në ndonjë juridiksion tjetër (siç është pretendimi në rastin konkret që mosmarrëveshja duhet t'i nënshtrohet procedurës së arbitrazhit), ka rëndësi të madhe për vetë fatet e çështjes dhe për zgjidhjen përfundimtare të saj. Kjo është dhe arsyeja se përse Kodi i Procedurës Civile mungesën e juridiksionit gjyqësor e ka konsideruar si një nga shkeljet më të rënda të normave procedurale, gjë që sjell si pasojë prishjen e vendimit nga gjykatat më të larta (neni 472, pika (b) në referencë të nenit 467).

Në nenin 59 të K.Pr.Civile parashikohet shprehimisht se: "*Gjykata në çdo fazë dhe shkallë gjykimi, qoftë edhe kryesisht, merr në shqyrtim nëse çështja që shqyrton bën pjesë në juridiksionin gjyqësor apo administrativ. Kundër vendimit të dhënë për një rast të tillë, mund të bëhet ankim i veçantë në Gjykatën e Lartë*".

Në analizë të dispozitës së mësipërme konstatohet se çështja e juridiksionit mund të jetë objekt shqyrtimi gjyqësor nga çdo gjykatë e pushtetit gjyqësor dhe në çdo fazë gjykimi. Çdo lloj gjykate dhe në çdo shkallë gjykimi ka të drejtë të marrë në shqyrtim, të analizojë dhe të vendosë nëse çështja është në juridiksionin gjyqësor, nëse është në juridiksionin administrativ, nëse është në juridiksionin kushtetues, nëse duhet të gjykohet nga gjykata e arbitrazhit, nëse subjekti kërkues është një subjekt i huaj, i cili gëzon imunitet diplomatik, etj.

Këtë gjë gjykata mund ta bëjë *edhe kryesisht,* pra dhe pa u pretenduar nga palët dhe kjo pasi çështja e juridiksionit është e lidhur ngushtë me elementet që përbëjnë administrimin e

procesit gjyqësor, si dhe me të drejtën për një proces të rregullt ligjor të sanksionuar në nenin 6 të KEDNJ.

Në këto kushte, sa herë që çështja e juridiksionit bëhet objekt shqyrtimi gjyqësor, fati i procesit gjyqësor do të varet nga vendimi që merr Gjykata e Lartë në fund të shqyrtimit të kësaj çështje. Në nenin 59, pika 2 të K.Pr.Civile është parashikuar shprehimisht se: *"Kundër vendimit të dhënë për një rast të tillë mund të bëhet ankim i veçantë në Gjykatën e Lartë"*.

Vetëm vendimi i Gjykatës së Lartë, i cili pranon ekzistencën e juridiksionit gjyqësor gjatë shqyrtimit të një çështje, i hap rrugë shqyrtimit të çështjes, pa paragjykuar në asnjë rast themelin e saj. Në këto kushte *"Gjykimi i filluar pezullohet derisa të jepet vendimi për zgjidhjen e mosmarrëveshjes për juridiksionin. Gjykata mund të marrë vetëm masa për sigurimin e padisë dhe të kryejë veprime procedurale që nuk presin"* (neni 60, pika 2 i K.Pr.Civile).

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë vlerëson se pavarësisht se këto dispozita flasin për konfliktin midis juridiksionit administrativ dhe atë gjyqësor, i njëjti parim respektohet dhe në rastin e konfliktit që mund të ekzistojë midis juridiksionit gjyqësor dhe juridiksionit të gjykatave të arbitrazhit, nga ana e gjykatës së arbitrazhit, apo nga organet gjyqësore të zakonshme.

Domosdoshmëria e zgjidhjes së këtij konflikti nga Gjykata e Lartë vjen pasi klauzola e arbitrazhit e rënë dakord mes palëve bën që pushteti gjyqësor të mos ketë juridiksion për shqyrtimin e mosmarrëveshjes, *me përjashtim të rastit kur kjo marrëveshje është e pavlefshme.*

Në rastin objekt gjykimi, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë mbi kërkesë të palës së paditur, Shoqëria "Sphinx" shpk, ka marrë në shqyrtim pretendimin nëse kjo çështje bën pjesë në juridiksionin gjyqësor apo duhet referuar në arbitrazh në përputhje me parashikimet e pretenduara nga kjo palë në nenin 17 të "Marrëveshjes për blerjen dhe instalimin e sistemit të sigurisë", me nr. Prot 015/14.

Ky Kolegj nuk e gjen të mbështetur konkluzionin e kësaj gjykate se çështja duhet të nxirret jashtë juridiksionit gjyqësor, sipas klauzolës së parashikuar në nenin 17 të "*Marrëveshjes për blerjen dhe instalimin e sistemit të sigurisë*", me nr. Prot 015/14, referuar shkakut dhe objektit të padisë.

Neni 17 i "*Marrëveshjes për blerjen dhe instalimin e sistemit të sigurisë*", me nr. Prot 015/14, parashikon ndër të tjera se: *"…Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin midis tyre në lidhje me marrëveshjen, do të zgjidhen në përputhje me rregullat e Arbitrazhit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë nga një arbitër të caktuar në përputhje me rregullat. Arbitrazhi bëhet në Tiranë, Shqipëri në gjuhën shqiptare, nëse nuk është e mundur arbitrazhi do të bëhet në Paris, Francë në gjuhën angleze. Çmimi i arbitrazhit do të jetë përfundimtar dhe vendimtar mbi palët."*

Në referim të ligjit sa sipër si dhe shkakut dhe objektit të padisë së paditësit në çështjen në gjykim edhe sikur të merret e mirëqenë klauzola e arbitrazhit e parashikuar në nenin 17 të "*Marrëveshjes për blerjen dhe instalimin e sistemit të sigurisë*", me nr. Prot 015/14. Ky Kolegj vlerëson se mosmarrëveshja ndërmjet palëve nuk ka të bëjë me mosmarrëveshje ndërmjet palëve brenda objektit të klauzolës së Arbitrazhit, *me vlefshmërinë* e kontratës as me

interpretimin e saj, të cilat mund të zgjidheshin me klauzolë arbitrazhi, por *me goditjen e një titulli ekzekutiv*.

Padia "*Pavlefshmëria e Titullit Ekzekutiv*", e cila godet një titull ekzekutiv, parashikuar nga Neni 609 i Kodit të Procedurës Civile, është një gjykim themeli që përqendrohet mbi shqyrtimin e masës dhe sasisë së të drejtës materiale që gjendet në titullin ekzekutiv, ***dhe është tej objektit të marrëveshjes së arbitrazhit e cila është një zgjidhje alternative vetëm në lidhje me mosmarrëveshje civile tregtare***.

Me titull ekzekutiv do të kuptojmë *atë akt të parashikuar shprehimisht nga ligji, i cili,* ***duhet të përmbajë një detyrim të njohur e të përcaktuar saktë, të kërkueshëm, që nuk lidhet me plotësimin e afateve të caktuara****, dhe, mbi të gjitha, të pakushtëzuar nga rrethana të tjera apo nga detyrime të tjera të ndërsjella, sikurse mund të jenë edhe veprimet e aktorëve të tjerë gjatë ekzekutimit të detyrueshëm ashtu sikurse mund të jetë edhe përmbaruesi gjyqësor*.

Padia për goditjen e një titulli ekzekutim mund të ngrihet në fazën e ekzekutimit të një titulli ekzekutiv, ende pa u ekzekutuar detyrimi. Në këtë padi legjitimohet aktivisht vetëm debitori dhe legjitimohet pasivisht kreditori, që janë subjekte të marrëdhënies juridike procedurale që lind gjatë fazës së ekzekutimit të titullit ekzekutiv, të cilët jo gjithmonë janë të pandryshueshëm (*rastet e suksedimit të të drejtave*), por që identiteti i tyre juridik nuk ndryshon.

Shkaku ligjor i padisë së pavlefshmërisë së titullit ekzekutiv qëndron në të drejtën e debitorit, që parashikohet në nenin 609 të Kodit të Procedurës Civile, për t'u çliruar nga një detyrim i cili rrjedh nga titulli ekzekutiv, për shkak të mospërputhjes ndërmjet realitetit që përfaqëson titulli ekzekutim, me realitetin që ekziston efektivisht, kur e drejta e kreditorit ***nuk ka ekzistuar si e tillë që në origjinë*** ose për fakte shues ose formuar të ngjara pas formimit të titullit sikurse jemi në rastin konkret. *Pra, siç shihet, shkak për ngritjen e kësaj padie bëhet mospërputhja që ekziston mes të drejtës së pasqyruar në një titull ekzekutiv me gjëndjen faktike (të drejtës që ekziston konkretisht)*[1].

Mbështetur në definicionin e shkakut ligjor të padisë në përgjithësi, konkludojmë se shkaku ligjor i padisë së pavlefshmërisë së titullit ekzekutiv qëndron në të drejtën e kreditorit, që gjen pasqyrim në nenin 609 të K.Pr.Civile, për t'u çliruar nga një detyrim, i cili rrjedh nga titulli ekzekutiv, për shkak të mospërputhjes ndërmjet realitetit që përfaqëson titulli ekzekutiv, ***me realitetin që ekziston efektivisht, kur e drejta e kreditorit nuk ka ekzistuar si e tillë që në "origjinë"*** ose për fakte shuese apo penguese të ngjara pas formësimit të titullit.

Në parim titulli ekzekutiv, për sa kohë shoqërohet me urdhrin e ekzekutimit konsiderohet *prima facie* i vlefshëm për t'u ekzekutuar, por kjo nuk përjashton mundësinë që ai të jetë prekur nga vese të tilla që e bëjnë atë të pavlefshëm. Këto vese mund të lidhen me formën apo me përmbajtjen e titullit ekzekutiv. Pra, titulli ekzekutiv mund të jetë i pavlefshëm për shkak ***të mungesës së formës, elementeve përbërës të tij*** ose për shkak të mungesës të elementeve që lidhen me përmbajtjen, themelin e tij.

Për sa më sipër padia "*Pavlefshmëria e Titullit Ekzekutiv*", është një padi e rregullt e cila i përket ekskluzivikisht juridiksionit gjyqësor, bazuar në nenin 609 të K.Pr.Civile.

[1] Vendim i Gjykatës së Lartë, Kolegji Civil, Nr.00-2010-815 i Vendimit (214), dt. 06.05.2010.

Në analizë të sa më sipër, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë arrin në përfundimin se vendimi nr.1214, datë datë 18.02.2016, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë duhet të prishet dhe çështja duhet të kthehet pranë asaj gjykate për vazhdimin e gjykimit.

PËR KËTO ARSYE

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, mbështetur në nenet 59 dhe 485 të K.Pr.Civile,

V E N D O S I

Prishjen e vendimit nr.1214, datë 18.02.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe kthimin e çështjes për vazhdimin e gjykimit pranë asaj gjykate.

Tiranë, më 01.06.2016

A N Ë T A R	**A N Ë T A R**	**K R Y E S U E S**
Admir THANZA	**Majlinda ANDREA**	**Artan BROCI**

Vërtetohet njësia me origjinalin P.Adm.Gjyq. D.Qerimi B.A.